

VENDIM
Nr. 80, datë 26.5.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY MARKET” SHPK, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe 39 pika 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 4, pika 1, germa “d”; neni 5, pika 1, germa “d”, neni 13; të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.5.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 54, datë 18.4.2017, vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë Alb Energy Market sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1” dhe “c1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Alb Energy Market sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 (pesë) - vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

